

SHPALLJE

PËR PUNË PRAKTIKE PËR STUDENTË

Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK), është duke zbatuar projektin *“Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës”* projekt trevjeçar (2020-2022), i përkrahur nga Donatori Bread for the World nga Gjermania. Projekti do të përfshijë komunitat: Kamenicë, Lipjan, Skënderaj, Shtime, Viti dhe Vushtrri.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit është planifikuar përkrahja e të rinjve/studentëve me punë praktike, si mundësi për punësim apo vetë-punësim. Përmes këtij aktiviteti paraprakisht do të organizohen 5 ditë trajnime profesionale për aftësitë e buta. Pas përfundimit të trajnimeve, studentët do të sistemohen në punë praktike në kompani/institucione përkatëse, për të cilat ata kanë vendosur paraprakisht.

Andaj ftohen të rinjtë/studentët e universiteteve publike dhe private, të cilët në fushëveprimtarinë e tyre e kanë bujqësinë, veterinarinë apo teknologjinë ushqimore, që të aplikojnë për angazhimin në praktika të ndryshme që përshtaten me profesionin e tyre. Gjatë zbatimit trevjeçar të projektit do të përkrahen gjithsej 45 të rinjë/student me punë praktike, ose çdo vit do të përfshihen nga 15 studentë. Ky grup do të kryej punë praktike në kompani, institucione dhe organizata të ndryshme, ku gjatë punës praktike në periudhë prej 3 muajve, të rinjtë/studentët do të kenë një kompensim në baza mujore për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit, ushqimit dhe komunikimit. Kandidatët e përzgjedhur duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara me projekt.

KRITERET QË DUHET PLOTËSUAR KANDIDATËT JANË :

- Studentët e interesuar për punë praktikë duhet të jenë nga këto komuna: Kamenicë, Lipjan, Skënderaj, Shtime, Viti dhe Vushtrri;
- Student të cilët kanë diplomuar viteve të fundit apo që janë në përfundim të studimeve të drejtimit të bujqësisë dhe veterinarisë, përfshirë teknologjinë ushqimore;
- Student të papunë dhe që nuk kanë kryer praktikë më parë;
- Studentët që shprehin gatishmëri/përkushtim për pjesëmarrje në trajnime dhe punën praktike në kompani/agrobiznese, institucione dhe organizata tjera;

Aplikacioni mund të merret dhe dorëzohet në:

- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni këtu: <https://biturl.top/iIVZNz>
- Nëpërmjet adresës elektronike: hasan.cena@iadc.org;
- Zyrat e IADK-së, me adresë Fshati Sfarçak i Ulët, Nr.11, Vushtrri, Kosovë;

Afati për aplikim është deri më **21.01.2022**. Për informata shtesë mund të kontaktoni në **+383 (0) 49 973 211**.

Sinqerisht,

Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv